



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:205162

Datë: 07.07.2020

Numri i dokumentit: 01011423

P. nr. 1/20

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Gjakovë/ Dega Malishevë- Departamenti i Përgjithshëm- gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. M. nga Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupore nga neni nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II. nr.1079/19, të datës 16.09.2019, në shqyrtimi fillestar të mbajtur më datën 11.03.2020, në prezencën e prokurorit te shtetit Dëshire Jusaj, të dëmtuarës Sh. B., mbrojtësit të viktimave A. P., të akuzuarit A. M. dhe mbrojtësit të tij D. K. avokat në Malishevë, më datën **16.03.2020 nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. M.**, nga i ati M. e ëma S., e gjinisë J., i lindur më datën ..., nga Malisheva rruga "J. M. ", pa numër, i martuar, atë i 3 fëmijëve, ka te kryer shkollën fillore, i gjendjes dobët ekonomike, i parë i dënuar.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datën 20.08.2019, rreth orës 01:00, në rrugën "J. M.", në M. pikërisht në shtëpinë e tyre të përbashkët me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore dhe kryen dhunë ose keqtrajtim fizik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda në familje, në atë mënyrë që pas disa mosmarrëveshjeve paraprake dhe xhelozie, ditën kritike i dyshuari kishte filluar të e provokojë me fjalë e më vonë ka kërkuar një kafe nga bashkëshortja e dëmtuara Sh. B., dhe pasi që e dëmtuara ia ofron kafe fillojnë prapë të zihen me fjalë dhe më pas për një moment i pandehuri e sulmon të dëmtuarën fizikisht duke e goditur me grushte dhe me shqelma në pjesë të ndryshme të trupit, më ç 'rast të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore sipas akt ekspertimit mjeko-ligjor të datës 04.09.2019 të Dr. V. K..

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata ma aplikimin e neneve 4,7,17,38,39,40,42,69,70,71, lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, si dhe neneve 248, 359 par. 2, 365, 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 të KPPK-së të akuzuarin:

E G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë e një (151) ditëve, **NË TË CILIN DËNIM I LLOGARITET KOHA E KALUAR NË PARABURGIM NGA DATA 20.08.2019 DERI MË DATËN 17.01.2020.**

Detyrohen i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 30,00 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Sh. B. nga M. rruga "J. M. ", për realizimin e kërkesë pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PP/II. nr. 1079/19, të datës 16.09.2019, kundër të akuzuarit A. M. nga Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupore nga neni nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4, lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.21.10.2019, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Gjykata sipas Aktgjykimit P. nr. 191/19 dt. 24.10.2019, të akuzuarin e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve.

Gjykata e Apelit të Kosovës sipas Aktvendimit PA1 nr. 1457/2019 dt. 17.01.2020, ka anuluar aktgjykimin P. nr. 191/19 dt. 24.10.2019, dhe e ka kthyer të njëjtën në ri gjykim dhe vendim.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.11.03.2020, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Prokurori i shtetit Dëshire Jusaj, pas leximit të aktakuzës bëri rikualifikimin e veprës penale me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Prokuroria e Shtetit Dëshire Jusaj deklaron se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë pranimi i fajësisë ka mbështetje ne provat të cilat gjenden ne shkresat e lendes pranimi i fajësisë është ber ne mënyrë vullnetarë pas konsultimit me mbrojtësin e tij për çka në tersi ekziston dyshimi i bazuar se i njëjti është përgjegjës ne veprimet e tij, duhet te përgjigjet penalisht po ashtu meqenëse dhuna e shkaktuar ka qene brenda familjes kërkojnë nga gjykata e njëjta me qenë se ka të bej me raporte familjare te merret edhe si rrethanat rëndues pasi që ka të bej me raportin e familjes, me rastin e caktimit të dënimit.

Mbrojtësi i viktimave A. P. deklaron se pas dëgjimit se palës së dëmtuar e cila u deklarua gjatë seancës së sotme se e le ne vlerësim të gjykatë sa i përket çështjes së dënimit e po ashtu nuk kërkon edhe kompensim dëmi e mbështesim fjalën e prokurores së shtetit për pranimin e fajësisë nga ana e pandehurit prandaj nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë i propozoj gjykatë së në rast të dënimit ti merr për bazë rrethanat lehtësues po ashte edhe ato rendues.

E dëmtuara Sh.B., deklaron se kërkoj që te dënohet i akuzuari dhe nuk kërkoj kompensim dëmi, të njëjtën ia lë gjykatës dhe nga ajo ditë nuk kam pasur asnjë problem, tash jetoj të familja ime.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. M. av. D. K., deklaron se pasi unë jam konsultuar me te mbrojturin tim e mbështes pranimin e fajësisë nga ana e tij, dhe i propozoj që të merr parasysht rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit pasi i pandehuri ka deklaruar se është penduar se dhe nuk do ta përsëris ma vepër tjetër në të njëjtën lëndë ka qenë i paraburgosur dhe i dënuar me burg, të cilin e ka mbajtur ne tersi në kohëzgjatje prej 5 muajve, prandaj i propozoj gjykatës që të ti merr të gjitha këto rrethana.

I pandehuri A. M., deklarohet i fajshëm për veprën penale, ndiej keqardhje, i kërkoj falej bashkëshortes time, ka ndodhur rasti por nuk ka ndodhur me qëllim ka ndodhur prej stresit prej kushteve ekonomike, pasi që unë burgun e komë mbajt 5 muaj, dhe i premtoj gjykatë se nuk do të përsëris vepër tjetër penale.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestarë u vërtetua se aj me datë, kohë dhe vend si në diapozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit nr. ... dt. 20.08.2019; raporti policore mbi marrjen në pyetje të dyshuarit/ pandehurit A. M. dhënë në Stacioni Policore M. nr. ... dt. 20.08.2019; raporti policore mbi marrjen në pyetje të viktimës-dëmtuarit Sh. B.dhënë në Stacioni Policore M. nr. ... dt. 20.08.2019; foto dokumentacioni; raporti i policit Z. K. nr. ... dt. 20.08.2019; ekspertiza mjeko- ligjore e dr. V. K. dt. 04.09.2019; Q. K. M. F Malishevë raporti mjekësor për sh. B. nr. ... dt. 20.08.2019, si dhe shkresat tjera te lendes.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Gjyqtari me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është i martuar dhe ka tre fëmijë, ndien keqardhje, i ka kërkuar falje bashkëshortes, e njëjta ka ndodhur nga stresi dhe kushtet ekonomike, ka qëndruar për këtë rast në paraburgimit në kohëzgjatje prej 5 muajve, i premtun gjykatës se nuk do të përsëritë vepër tjetër penale, e dëmtuara nuk ka kërkuar kompensim dëmi, nga jo dite nuk ka pasur problem me të akuzuarin, jetojnë të ndarë, e dëmtuara jeton në familjen e familjes së sajë, Gjykata ka gjetur se i akuzuari është recidivis ku edhe më parë është dënuar me aktgjykime të ndryshme të cilat janë të vërtetuar sipas aktgjykimeve të Gjykatës sipas lendeve dhe atë: 1. i dënuar me kusht 3 muaj brenda 1 viti sipas lëndës P. nr. 99/11 i plotfuqishëm 25.11.2014; 2. i dënuar me gjobë në shumën prej 200 euro sipas lëndës P. nr. 535/11 i plotfuqishëm me 20.03.2013; 3. i dënuar me gjobë në shumën prej 200 euro sipas lëndës P. nr. 666/11 i formës së prerë 27.06.2012; 4. i dënuar me gjobë në shumën prej 200 euro sipas lëndës P. nr. 375/14 i plotfuqishëm më 17.06.2015, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e nenit 69 Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit dhe nenit 70 Rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë e një (151) ditëve, në të cilën dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 20.08.2019 deri më datën 17.01.2020, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2. 6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

JYKATA THEMELORE GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P. nr. 1/20, Datë: 16.03.2020

Zyrtarja ligjore
Albane Morina

Gjyqtari
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.